

12.02.2022
Ora 18:27

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e përmbajtjes së fletëve të votimit për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2. Stafi KQZ: **Y. Merkaj, M. Koja**
- **Parti Politike:** **PD (M. Logu), LSI (A. Kaziaj)**

Z. I . Celibashi: Fillojmë seancën e cila ka në rend dite vetëm një çështje për shqyrtim “Për miratimin e përmbajtjes së fletëve të votimit për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie, në gjashtë bashkitë, të datës 6 Mars 2022”.

Z. Y. Merkaj: Në mbledhjen e datës 12 shkurt 2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, miratoi shortin për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore në fletën e votimit për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022. Nisur nga vendimi i Komisionerit për renditjen e subjekteve në fletën e votimit për çdo zonë zgjedhore, kemi përgatitur fletën e votimit model, të cilën ua kemi paraqitur edhe partive politike. Për më tepër do të jetë diskutimi i partive politike. Bashkëlidhur paraqesim modelet e fletës së votimit për të gjashtë bashkitë, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.02.2022*

Z. I. Celibashi: Faleminderit, u japim fjalën përfaqësuesve të partive politike, meqenëse në parim jemi dakord me projektaktin, për diskutim në lidhje me përmbajtjen e fletës së votimit. Po, përfaqësuesi i Partisë Demokratike!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit zoti Celibashi! Siç me të drejtë u relatua nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm, në orën 12:30 ne kemi qenë të pranishëm dhe është hedhur shorti për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore në fletën e votimit, me të cilin nuk ka pas asnjë kundërshtim nga ana e asnjë pale. Për shkak të afateve të shkurtëra u dakordësua që në orën 17:30 të mbledheshim për të miratuar edhe fletët e votimit që do të përdreshin për zgjedhjet e pjesshme të datës 6 Mars 2022. Duke rënë dakord që paraprakisht, parimisht do të na dërgoheshin modelet, ose një model të paktën i fletëve të votimit që propozohej. Nga ana e administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ne kemi marrë një e-mail në orën 17:00, pra rreth 30 minuta para fillimit të mbledhjes që ishte njoftuar. Na janë vënë në dispozicion fletë votimi të këtij modeli, të cilin edhe për shkak të kohës së shkurtër nuk kam pas mundësi të komunikoj menjëherë me personin të cilin është i ngarkuar pranë Partisë Demokratike, nga ana e kryetarit lidhur me koordinimin e procesit zgjedhor. Përkatësisht Sekretarin e Përgjithshëm të Partisë Demokratike, zotin Gazmed Bardhi, i cili për këtë fletë votimi, më ka shprehur dy shqetësime. Shqetësimi i parë ka qenë që përbri partive politike, apo subjekteve zgjedhore nuk ishte logoja. Kjo është një kërkesë e nenit 98, pika 3 të Kodit Zgjedhor. Nga ana tjetër, zoti Bardhi, më ka shprehur shqetësimin që edhe në rastet kur ka pas koalicione në të gjitha proceset zgjedhore të mëparëshme, ose përbri emrit të koalicionit, ose poshtë emrit të koalicionit, ka pas gjithmonë subjektet zgjedhore që janë pjesë e këtij koalicioni. Pra, partitë që bëjnë pjesë në këtë koalicion. Për shkak të kohës së shkurtër në dispozicion, unë personalisht kam pas një komunikim

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.02.2022*

në telefon edhe me ju dhe ju kam shprehur këto dy shqetësime. Koha ishte e shkurtër dhe nuk do të donim që të vinim në këtë seancë dhe më pas të zvarrisnim procesin. Duhet të ecim sa më shpejt është e mundur duke pas parasysh edhe afatet. Fletët e votimit që na u dërguan në orën 18:04 minuta nga administrata zgjedhore, konstatojmë se një nga shqetësimet tona që ka pas të bëjë me vendosjen e logos përbri emrit të subjektit zgjedhor është reflektuar. Në këtë kuptim e vlerësojmë këtë reflektim të shpejtë, që është dhe një kërkesë e nenit 93, pika 3 e Kodit Zgjedhor. Nga ana tjetër, siç e shpreha në komunikimin e mëparshëm që kam pas me ju, por dhe publikisht, në të gjitha rastet kur ka pas subjekt zgjedhor një koalicion, përfshi dhe zgjedhjet e 25 prillit, gjithmonë ose përbri subjektit zgjedhor, pra koalicionit, ose poshtë tij kanë qenë partitë pjesëmarrëse të këtij koalicioni. Në këto zgjedhje, i nderuar zoti Komisioner, ne nuk mund të sillemi sikur nuk e njohim realitetin. Kanë një specifikë, të cilën kemi pas mundësi ta diskutojmë dhe në seancën e datës 4 shkurt 2022, në momentin që është regjistruar Koalicioni “Shtëpia e Lirisë”, që kishte të bënte me një përpjekje, në vlerësimin tonë të qëllimshëm. Në çdo rast në kundërshtim me kërkesat e nenit 65 të Kodit Zgjedhor, për të përfshirë një subjekt që kishte emër të ngjashëm, ose të njejtë me Partinë Demokratike të Shqipërisë. Kështu që me qëllim se është dhe fryma e vetë nenit 98, po të kemi parasysh pikën 4, me qëllim që zgjedhësi ditën e votimit të jetë sa më i qartë lidhur me partinë që ai kërkon të mbështesë dhe kandidatin përkatës të kësaj partie. Do të donim që në këtë fletë votimi krahas elementeve të tjerë që janë pasqyruar, poshtë emrit të Koalicioni “Shtëpia e Lirisë”, ose në krahun e saj të ishin dhe dy subjektet zgjedhore që e përbëjnë këtë koalicion. Përkatësisht LSI dhe PDK, në përputhje dhe reflektim edhe të vendimit nr. 46, datë 4 shkurt 2022 të marrë pikërisht nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për regjistrimin e këtij koalicioni zgjedhor me këto dy parti si pjesëmarrëse në të. Për pjesën tjetër jemi dakord parimisht!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.02.2022*


Z. I. Celibashi: Faleminderit zoti Logu! Përfaqësuesi i Koalicionit “Shtëpia e Lirisë”!

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i Koalicionit “Sh-L”-së: Faleminderit zoti Komisioner! Unë nuk kam komunikuar me ata që përfaqësoj, me koalicionin. Unë jam i bindur që kjo fletë përmban të gjithë elementet e parashikuara në nenin 97 dhe 98. Nuk kam dhënë ndonjë autorizim, që autorizoj dikë të kërkojë vënien e elementeve të papërcaktuar në ligj, në fletën përkrah koalicionit që përfaqësoj, as në këtë sallë dhe as jashtë kësaj salle. Unë mbaj përgjegjësi, kam të drejtat dhe detyrimet kundrejt përfaqësimit të këtij koalicioni. Mendojmë që propozimi i bërë nga ana juaj dërguar në rrugë elektronike përmban të gjithë elementet e ligjit. Nuk sjell konfuzion tek zgjedhësit. Fleta e votimit është shumë e pasur, nuk ka dyzime të logove, apo të vetë shkronjave nistore, të cilat mund të shkaktojnë konfuzion tek zgjedhësit. Këto janë kërkesat e veçanta të ligjit. Pastaj se ku e gjejmë kërkesën që duhet kjo, duhet ajo, në emër dhe për llogari të të tretëve, këtë gjë unë nuk e kuptoj.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Po, fjala përsëri për ju zoti Logu!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Nuk kam asnjë replikë i nderuar, e nuk do të kem asnjë replikë me askënd në këtë sallë. Unë përfaqësoj qëndrimet e subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë. Ne vlerësojmë, sigurisht është kërkesë e nenit 65 si formohen koalicionet. Pra, koalicionet formohen nga dy subjekte zgjedhore, përkatësisht parti politike të regjistruara në zgjedhje. Neni 66 në frymë e në gërmë përpiqet që të evitohet në çfarëdo mënyre konfuzionin e zgjedhësit. Ashtu siç përpiqet edhe neni 98, kam parasysh këtu, megjithëse rregullimi është vetëm për fletën e votimit për zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë. Sigurisht i njejtë parim do të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.02.2022*

duhet të ndiqet edhe për zgjedhjet vendore, qofshin ato të pjesshme, apo qofshin të shtrira në të gjithë territorin e vendit. Nga ana tjetër është po ashtu e rëndësishme të mbahet parasysh se tradita e zgjedhjeve në Shqipëri nuk ka filluar sot, nuk ka filluar dje as me mua, as me ndonjë tjetër. Ka filluar vite më parë dhe të paktën në ato fletë votimi që patëm mundësi të konsultojmë, të vitit 2015 dhe të vitit 2021, shohim që poshtë emrit të koalicionit janë edhe subjektet zgjedhore, pjesë e këtij koalicioni. Pra, të respektohet edhe fryma edhe germa e nenit 66 të Kodit Zgjedhor, e nenit 98 dhe sigurisht edhe tradita e mirë që kanë pasur zgjedhjet në Shqipëri të paktën në këtë aspekt. Kjo është kërkesa jonë, prandaj nuk besoj që kërkojmë diçka jashtë ndonjë logjike të caktuar. Kërkojmë të respektohet, apo të reflektohet ajo që ka ndodhur gjithmonë. Në fakt kërkojmë të respektohet ajo që është edhe vendimmarrja e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në vendimin nr. 46, dt.4.02.2022, i cili ka përcaktuar qartë se kush është koalicioni. Cili është emri i koalicionit, cilat janë shkronjat nistore të tij dhe cilat janë subjektet zgjedhore që e përbëjnë atë. Përkatësisht në aktin konkret Koalicioni “Shtëpia e Lirisë” – Lëvizja Socialiste për Integrim dhe Partia Demokristiane. Lidhur me pretendimin që ne nuk flasim vetëm në emër të Partisë Demokratike, por edhe për çështje që kanë të bëjnë me subjektet e tjera, duhet të themi që ne marrim pjesë në këto zgjedhje dhe çdo element i këtij procesi zgjedhor që garanton mbarëvajtjen për zhvillimin e zgjedhjeve sa më të rregullta është në interes të Partisë Demokratike që unë përfaqësoj, por dhe të subjekteve të tjera zgjedhore. Veçanërisht në rastin kur s’kemi këtu pse të fshihemi pas gishtit. Kemi parë dje, kemi parë pardje individë të caktuar, që tashmë janë kandidatë të regjistruar zyrtarisht në emër, apo përfaqësues të Koalicioni “Shtëpia e Lirisë” që shfaqen me logon dhe simbolet zyrtare të Partisë Demokratike. Të paktën me sa kemi mundësi të shohim edhe atë çështje që jemi duke e shqyrtuar dhe do ta adresojmë në një moment të caktuar. Të paktën me aq sa ka mundësi Komisioni

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.02.2022*

Qendror i Zgjedhjeve nëpërmjet mekanizmave që i ka dhënë ligji dhe aktet nënligjore të nxjerra nga vetë komisioni, të shmangim çfarëdo lloj përpjekje që bëhet e qëllimshme ose e paqëllimshme qoftë për konfuzion, për paqartësi të zgjedhësi, të votuesi. Duhet të kemi parasysh këtu dhe kohën shumë të shkurtër që kanë në dispozicion kandidatët për fushatë zgjedhore. Po të ishim ndoshta në kushte pak më optimale, do të ishte më me mundëshme që partitë dhe kandidatët të sqarojnë zgjedhësin. Kjo është kërkesa jonë. Kjo është në përputhje të plotë me ligjin dhe synon vetëm e vetëm qartësinë dhe eliminimin e çdo konfuzioni për zgjedhësin.

Z. I . Celibashi: Po, përfaqësuesi i koalicionit, e fundit besoj dhe t'i mbylлим diskutimet!

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i Koalicionit "Sh-L"-së: Fakti është që nuk na u tha një dispozitë ligjore mbi të cilën do të mbështetet kjo kërkesë. Na duket krejt alogjike. Sjell në vëmendje të Komisionerit dhe besoj se është në dijeni të një ankimimi në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, për të cilën subjekti kërkues dhe parafolës, nuk është legjitimuar për të marrë pjesë në çështje të natyrës që nuk cënojnë interesin e atij subjekti. Ky qëndrim duhet mbajtur parasysh dhe nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve për shkak të një vendimmarrjeje të marrë nga një organ kolegjal i cili nuk e ka legjitimuar për çështje të karakterit "të mos cënimit të interesave", në momentin që nuk i cënohen interesat. Ne sipas marrëveshjes kemi sjellë logon tonë, emrin e koalicionit dhe shkronjat nistore. Këto janë elemente të mjaftueshëm që zgjedhësit të mos konfondohej dhe elemente që nuk cënojnë asnjë subjekt tjetër politik në këto zgjedhje, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.02.2022*

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Mendoj që mjaftueshëm secili prej jush prezantoi mendimet e veta në lidhje me përmbajtjen e fletës së votimit. I mbyllim diskutimet! Vlerësimi im si Komisioner me këto pretendime është vijues. Kemi reflektuar sikurse tha dhe zoti Logu kërkesën për të vendosur në përmbajtjen e fletës së votimit edhe logot e partive politike dhe të koalicioneve. Mendoj që qoftë dhe në pikëpamje të përmbajtjes, por dhe në pikëpamje të paraqitjes, të formës fleta e votimit e cila është duke u prezantuar, kënaq interesat e ligjit. Lidhur me pretendimin që në rastin e shënimit të emrit të koalicionit “Shtëpia e Lirisë”, të shënohen edhe partitë politike përbërëse të këtij koalicioni, mendoj që duhet t’i qëndrojmë rigorozisht përmbajtjes së marrëveshjes që kanë paraqitur dy subjektet zgjedhore, parti politike në KQZ me rastin e kërkesës për regjistrim si subjekte zgjedhorë. Sipas marrëveshjes është përcaktuar qartë se kush është emri i koalicionit. Ka qenë në vlerësimin e tyre që emri i koalicionit të jetë “Shtëpia e Lirisë” dhe shkronjat nistore Sh-L dhe kaq! Është e vërtetë që në rastin e zgjedhjeve të 25 prillit, por dhe më herët, kanë qenë shënuar emrat e partive pjesëmarrëse në fletën e votimit. Kjo ka qenë kërkesë e subjekteve të cilat kanë qenë të interesuara për të regjistruar koalicionin. Kur kanë prezantuar emrin e koalicionit e kanë prezantuar emrin e tij bashkë me partitë përbërëse të koalicionit.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Ju lutem për procedurë, ndjesë! A mund të kemi një kopje të kërkesës përpara se të shkojmë më tutje? Unë mbaj mend që në atë kërkesë... kjo kërkesë që po bëj unë është e specifikuar edhe në atë kërkesë që ka bërë Lëvizja Socialiste për Integrim në datën 31 janar. Shtëpia e lirisë (LSI, PD-Komisioni i Rithemelimit, PDK).

Z. I. Celibashi: Jua demostroj unë, kemi marrëveshjen...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.02.2022*

Z. I. Celibashi: Nuk duam që... e kuptoj zoti Logu, por...

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: A ka qenë vetë kërkesa e ...

Z. I. Celibashi: Përtej asaj, ne e kemi shqyrtuar. Vendimi nr. 46 e ka të qartë. Të regjistrojë si subjekt zgjedhor pjesëmarrëse në zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie që do të zhvillohen në datën 6 Mars 2022, koalicionin e partive Lëvizja Socialiste për Integrim dhe Partia Demokristiane e Shqipërisë. Emri i koalicionit është “Shtëpia e Lirisë” nuk i kemi përfshirë partitë. Partia udhëheqëse e koalicionit është Partia Lëvizja Socialiste për Integrim dhe kaq. Në vijim me të drejtë të shqetësimit tuaj, për të mos... sepse thelbi i mënyrës së paraqitjes së emrave të subjekteve zgjedhorë në fletën e votimit është të evitojë konfuzionin që mund të krijohet tek zgjedhësit dhe te votuesit në procesin e votimit. Sikur se ju e thatë që dispozitat e Kodit Zgjedhor rregullojnë përmbajtjen e fletës së votimit për rastin e zgjedhjeve për kuvend. Ligji nuk është se e ka rregulluar qartësisht apo për të thënë që nuk e ka rregulluar aspak se si do të jetë përmbajtja e fletës së votimit në rastin e fletës së votimit për zgjedhjet vendore dhe thotë “vendoset emri i subjektit”. Atëherë me interpretim emri i subjektit në këtë rast është ai që është.

Mirë, e konsiderojmë të përfunduar seancën! Lidhjet do të jenë 1, 2, 3, 4, 5, 6 për secilën nga bashkitë do të jetë përmbajtja më vete.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i Koalicionit “Sh-L”-së: Mundësisht për shkak të afateve të na mundësohet zbardhja e saj që ditën e sotme!

Z. I. Celibashi: Po, do të zbardhet që sot, faleminderit!

Vendimi nr. 74

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

